



UNMIK/RREG/2004/16
28 maj 2004

RREGULLORE NR. 2004/16

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS
MBI MATERIALIN BIMOR**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 8.1, 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 10 maj 2004 lidhur me Ligjin mbi materialin bimor i miratuar më parë nga Kuvendi i Kosovës më 29 prill 2004,

Me anë të kësaj shpall të vlefshëm në datën e nënshkrimit Ligjin mbi materialin bimor të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2004/13), me kusht që:

a) Dispozitat e ligjit, veçmas ato të përcaktuara në nenet 16 deri 19, të zbatohen në përputhje të plotë me nenet 8.1(m) deri (p) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe shprehjet “import” dhe “eksport” dhe atyre që rrjedhin nga to të interpretohen për qëllimet e zbatimit në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe

b) Neni 26 korrigohej si vijon: “Ky ligj, pas miratimit nga Kuvendi, hyn në fuqi në ditën e shpalljes së tij nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”.

Nënshkruar sot, më 28 maj 2004.

Harri Holkeri,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm